

Z. Rushit Zejneli

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ju sqarojmë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dosjes tuaj të përfitimit me numër 260008 konstatuam se, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë me vendim nr.71, datë 28.02.2018, bazuar në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju ka caktuar pension invaliditeti të plotë nga grupi por të reduktuar nga vjetërsia, me periudhë sigurimi 22 vite e 1 muaj, me masë fillestare pensioni 11.392 lekë në muaj dhe me të drejtë pagese nga data 17.01.2018.

Në llogaritjen e vjetërsisë fillimisht ju janë përfshirë këto periudha:

28.07.1975 - 05.01.1979	S.M.T Kukës + Ushtar;
05.02.1979 - 06.04.1984	S.M.T. Kukës;
16.06.1984 - 01.08.1984	Reparti ushtarak nr.6600 Kukës;
15.03.1992 - 31.12.1993	Person Fizik;
01.01.1994 - 30.06.1994	Person Fizik;
01.01.1995 - 31.12.1996	Person Fizik;
01.04.2000 - 01.07.2001	Person Fizik;
01.09.2007 - 01.12.2008	Ardeno shpk;
01.01.2009 - 31.12.2011	Ardeno shpk;
01.01.2012 - 30.03.2012	Asistencë;
01.04.2012 - 30.09.2014	Person fizik;
01.12.2014 - 01.10.2015	Person fizik.

Sipas nenit 35, të ligjit nr.7703/1993 të ndryshuar, periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Ju jeni i datëlindjes 09.07.1957 dhe sipas vendimit të KMCAP-it koha e fillimit të invaliditetit është data 22.08.2016, sa më sipër periudha minimale e sigurimit është 29 vite e 3 muaj. Gjithashtu, sipas nenit 36, të ligjit nr.7703/1993 shuma e pensionit të invaliditetit të plotë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë dhe shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi. Në datën 22.08.2016 paga neto minimale ka qenë $19.536 \times 75\% = 14.652$ x 22 vite e 1 muaj: 29 vite e 3 muaj = $11.062 \times 3\% = 11.394$ lekë masa e pensionit në datën 17.01.2018.

Pensioni i invaliditetit ju është rishqyrtuar me vendim nr.71/1, datë 07.06.2018 sepse në llogaritjen e vjetërsisë ju është përfshirë periudha 01.08.1984-14.11.1991 që keni punuar në repartin ushtarak 6600 Kukës dhe pas këtij rishqyrtimi periudha e sigurimit rezulton 29 vite e 4 muaj ndërsa masa fillestare e pensionit 15.958 lekë në muaj.

Sipas vendimeve të mësipërme për llogaritjen e pensionit të invaliditetit është vendosur gabim periudha e detyrueshme e sigurimit 23 vite nga 29 vite e 3 muaj që duhej, prandaj pensioni ju është rishqyrtuar me vendim nr.71/2, datë 19.08.2019 sepse në llogaritjen e vjetërsisë ju është përfshirë periudha 01.10.2014-01.12.2014 dhe gjithashtu është vendosur periudha minimale e sigurimit 29 vite e 3 muaj. Pas këtij rishqyrtimi periudha e sigurimit ka rezultuar 29 vite e 6 muaj ndërsa masa fillestare e pensionit 15.091 lekë në muaj ($14.652 \times 1.03 = 15.091$ lekë) dhe si rezultat i uljes së masës së pensionit për periudhën 17.01.2018 - 30.08.2019 keni rezultuar debitor 17.144 lekë, e cila ju është mbajtur për periudhën 01.09.2019-30.04.2020.

Pensioni i invaliditetit ju është rishqyrtuar gjithashtu me vendim nr.71/3, datë 25.10.2019 sepse në llogaritjen e vjetërsisë ju janë përfshirë periudhat 01.10.2015-31.10.2015 dhe 01.12.2015-22.08.2016, por masa e pensionit nuk ka ndryshuar sepse sipas përcaktimit të nenit 36, të ligjit nr.7703/1993 shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Së fundmi, pensioni ju është rishqyrtuar me vendim nr.71/4, datë 29.12.2020 sepse në llogaritjen e vjetërsisë u përfshi periudha 22.08.2016-31.12.2017 sipas vendimit nr.2828, datë 06.11.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pas këtij rishqyrtimi masa fillestare e pensionit ka rezultuar 15.308 lekë periudha e sigurimit 31 vite e 8 muaj, ndërsa për periudhën 17.01.2018-31.12.2020 keni përfituar shumë kreditore 8.107 lekë, por pas ankesës në ISSH u konstatua se sipas këtij vendimi masa e pensionit është llogaritur gabim me kushtet e datës 22.08.2016, duhej llogaritur me kushtet e datës 31.12.2017, në kushtet e kësaj date shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi $21.312 \times 75\% = 15.984$ lekë prandaj dosja u dërgua për rishqyrtim në DRSSH Tiranë.

Sa më sipër, me vendim nr. 71/5, datë 18.10.2022 pensioni ju është rishqyrtuar me masë fillestare pensioni 15.984 lekë në muaj nga data 17.01.2018 dhe sipas nenit 62, të ligjit nr.7703/1993 keni përfituar shtesën kreditore 43.019 lekë, për periudhën 17.01.2018-30.10.2022, në muajin Nëntor 2022.

Masa aktuale e pensionit të invaliditetit është në vlerën 21,102 lekë në muaj.

Meqenëse keni plotësuar moshën për pension pleqërie në datën 09.07.2022 ju rekomandojmë të aplikoni për pension pleqërie që pas llogaritjeve të përfitoni pensionin që del më i lartë.

Faleminderit për bashkëpunimin.